





HARTA E PROBLEMATIKAVE VENDORE NË 4 NJËSITË ADMINISTRATIVE TË BASHKISË KURBIN

Mars 2022



www.PerQytetin.com



◆◆ CFARË ËSHTË NISMA ◆◆ “PËR QYTETIN”?

Një konsorciumi organizatash të udhëhequra nga Qëndresa Qytetare e cila synon të rrisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e Këshillave Bashkiake Tiranë, Durrës dhe Kurbin duke fuqizuar qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit për të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ato banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa elektronike. Kjo nismë mbështetet nga Lëviz Albania dhe SDC në Shqipëri.



Në thelb të kësaj nisme e është nxitja e ushtrimit të të drejtave ligjore të parashikuara në nenin 19 dhe 20 të ligjit 139/2015 për Vetqeverisjen Vendore të cilat garantojnë zbatimin e detyrimeve ligjore të bashkisë dhe rrisin cilësinë e qeverisjes. Gjithashtu demokracia vendore pasurohet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe grupeve të interesit në qeverisjen vendore dhe më së pari mundësohet nga qeverisja e mirë vendore.

Për Qytetin Vendos ti

Ne synojmë nxitjen dhe forcimin e demokracisë vendore dhe inkurajimin e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë.

◆◆ SI JANË MBLEDHUR TË DHËNAT E ◆◆ HARTËZUARA NË NJËSITË ADMINISTRATIVE?

Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor në 3 bashkitë e përfshira në këtë nismë, **Tiranë, Durrës dhe Kurbin** ku u pyetën **600 qytetarë**. Intervistuesit u lokalizuan në të gjitha njësitë administrative të bashkive për të komunikuar me banorët mbi problematikat që ata hasin. Të dhënat u mbledhën në rrugë digjitale, u përpunuan dhe u paraqitën në formën e hartës e cila shoqëron këtë material.

Ekipi i Qëndresës realizoi një verifikim faktesh të dytë duke fotografuar nga afër një pjesë të problematikave që shprehën banorët e këtyre njësisve administrative.



◆◆ KUJT I SHËRBEN HARTA E ◆◆ PROBLEMATIKAVE VENDORE?

Harta e problematikave vendore

Së pari: i shërben Këshillave Bashkiake dhe administratës së 3 bashkive për t'u njohur me shqetësimet e banorëve sipas zonave të tyre dhe për ti adresuar ato kryesisht, bazuar në detyrat dhe funksionet që u jep ligji për vetqeverisjen vendore.

Së dyti: harta i shërben organeve vendore për të ndërtuar planet strategjike, për të organizuar dëgjесat publike dhe buxhetin vendor.

Së treti: kjo hartë i shërben organizatave pjesë e konsorciumit dhe grupimeve të tjera qytetare për të ngritur në nivel advokimi dhe lobimi fushatat e tyre për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe rritjen e fokusit drejt problemeve të qytetarëve. Gjithashtu harta do të jetë një pikënisje për peticionet dhe iniciativat që do ti drejtohen Këshillave Bashkiake nga organizatat pjesë të këtij konsorciumi.

❖❖ BASHKIA E KURBINIT

Shtrihet në Shqipërinë qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Lezhë dhe Mirditë, në lindje me bashkinë Mat, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me Detin Adriatik.

Krahina e Kurbinit shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë së Mesme në zonën midis lumenjve Mat në veri dhe Drojë në jug. Nga veriu kufizohet me rrethet e Lezhës dhe të Mirditës, në lindje me rrethin e Matit, në jug me rrethet Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik. Rrethi i Kurbinit ka një sipërfaqe prej 271 km² dhe një popullsi prej 74 000 banorësh. Ka 1 njësi vendore prej të cilave 1 është bashki; Laçi dhe 3 janë njësi administrative, Mamurrasi, Miloti dhe Fushë-Kuqe.



❖❖ PETICIONI ONLINE

Të pyetur nëse i janë drejtuar më parë bashkisë ose administratorit të njësisë për këtë problemato shprehen se në shumicën e rasteve pra 169 persona i janë drejtuar njesise vendore per problematikat e tyre dhe vetem 10% e tyre kanë marrë përgjigje.


Të gatshëm për të nënshkruar peticione online janë shprehur 205 të anketuar nga 213 ne total.



❖❖ PYETËSORI MBI PROBLEMATIKAT

Qendra Rinore Sebastia në kuadër të projektit Për Qytetin ka kryer anketimet në terren të përcaktuara në katër njësitë administrative duke përfshirë edhe zonat rurale, ku fatkeqsisht problematikat infrastrukturore janë më të theksuara dhe mungesa e investimeve është shumë më e dukshme. Anketuesit tonë kanë dalë në terren për të intervistuar target grupe të ndryshme të komunitetit për të përcjellë një tablo më të qartë të problematikave lokale.

Në Kurbin janë kryer 213 anketime në grupmoshat si mëposhtë vijon:



Intervistuesit janë përzgjedhur rastësisht ku Vajzë/Grua janë **52%** Djalë/Burrë **48%**

Problematikat kryesore dale nga pergjigjet e banoreve në katër njësitë administrative, Fushë-Kuqe, Milot, Mamurras dhe Laç jane :






Fushë – Kuqe

- 1- Transporti publik
- 2- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 3- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve
- 4- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve
- 5- Rehabilitimi i sistemeve kulluese



Milot

- 1- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 2- Infrastruktura në kopshte dhe shkolla
- 3- Uji i pijshem mungon
- 4- Ndotja dhe shkatërrimi i lumit Mat
- 5- Transporti publik



Mamurras

- 1- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 2- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve
- 3- Transporti publik vendor
- 4- Infrastruktura në shkolla dhe kopshte
- 5- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve



Laç

- 1- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve
- 2- Qendrat sociale dhe kulturore
- 3- Infrastruktura në shkolla dhe kopshte
- 4- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 5- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve



Njësia administrative Milot shtrihet në një sipërfaqe prej 138 km² ku jetojnë 12856 banorë. Kufizohet në veri me Bashkinë e Rubikut, në verilindje me Komunën e Ulzës, në veriperëndim me Komunën e Zejmenit, në jugperëndim me Komunën e Fushë Kuqes, në jug me Bashkinë Laç në juglindje me komunën e Cudhinit, në jugperëndim me Bashkinë e Mamurrasit.

Miloti ka një qendër shëndetësore, ambulancë për çdo fshat dhe dy farmaci në qytetin e Milotit

Gjatë anketimit tonë janë intervistuar 54 banorë ku në bazë të përgjigjeve të tyre problematikat kryesore janë:

- 1- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 2- Infrastruktura në kopshte dhe shkolla
- 3- Uji I pijshem mungon
- 4- Ndotja dhe shkatërimi i lumit Mat
- 5- Transporti publik

Cit nga banorët: “Rruge te pashtruara dhe te pandricuara jane nje makth i vertete ne vere na myt pluhuri ne dimer balta”

Cit nga banorët: “ Une jam prind me 3 femije jam shkeputur nga puna se nuk kam ku te le femijet se nuk ka kushte ne cerdhe a kopeshte...”

Cit nga banorët:“ Në Shullaz jemi pa uje pa drita pa transport publik dhe pa asnje lloj investimi nga bashkia. Ndonese shume afer qytetit...”

Cit nga banorët: “ në verë mbushim ujë me bidona për t'u larë...”



Njësia administrative Fushë – Kuqe shtrihet në perëndim të bashkisë Kurbin. Ka në përbërje të saj fshatrat Gurëz, Gorre, Fushë-Kuqe, Adriatik dhe Patok. Aktiviteti kryesor ekonomik është turizmi pershkak të lagunës së Patokut dhe bujqësia.

Në këtë njësi ka një shkollë të mesme dhe 4 shkolla 9-vjecare. Në kuadër të projektit tonë janë intervistuar 43 banorë ku sipas përgjigjeve të tyre problematikat kryesore janë:

- 1- Transporti publik
- 2- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 3- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve
- 4- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve
- 5- Rehabilitimi i sistemeve kulluese

Cit nga banorët: “Vuajmë per fugona kush nuk ka makine personale ngel peng...”

Cit nga banorët: “Rruge te pa shtruara, mungon sinjalistika ,mungojne koshat e plehrave, mbledhja e tyre cdo dite...”

Cit nga banorët: “Dritat, rruga dhe transporti jane problem shume per Adriatikun...”

Cit nga banorët: “Mbetjet Jane shume problem...”



Njësia administrative Mamurras

Mamurrasi është një qytet me rreth 20.000 banorë. Ndodhet midis Laçit dhe Fushë-Krujës, e rreth 30 km në veri të kryeqytetit Tiranë. Mamurrasi ka edhe fshatrat e tij : Zhej, ShënMëri, Vilzë, Fushë-Mamurras, Gjorëm, Katund i Ri. Në lindje kufizohet me Burrelin, në perëndim laget nga deti Adriatik, në veri me Laçin, dhe në jug me Krujën. Në territorin e Mamurrasit funksionojnë një shkollë e mesme dhe 8 shkolla – 9vjeçare. Ka një qendër shëndetësore, ambulancë për çdo fshat.

Në kuadër të projektit “Për qytetin” janë intervistuar 51 banorë ku në bazë të përgjigjeve të tyre problematikat kryesore janë:

- 1- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 2- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve
- 3- Transporti publik vendor
- 4- Infrastruktura në shkolla dhe kopshte
- 5- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve

Cit nga banorët: “Hyrjet dhe daljet nga superstrada janë thuajse te padukshme, ndriçim s’ka fare...”

Cit nga banorët: “Makinat e pastrimit nuk vijne te heqin mbeturinat...”

Cit nga banorët: “ Janë mbyll shkollat se nuk ka ngrohëse...”

Cit nga banorët: “Nuk e kemi të gjithë luksin të levizim me makina personale, duhet të kemi transport publik...”

Cit nga banorët: “rrezikon te te shtypin makinat nga erresira...”



Njësia administrative Lac zë pjesën më të rëndësishme në

Bashkinë Kurbin, pasi është qendra e qytetit dhe janë të përqendruara aktivitet kryesore lokale. Në Lac jetojmë rreth 30000 banorë. Qyteti ka 5 shkolla 9 vjecare dhe nje shkolle të mesme. Aktiviteti kryesor ekonomik mbetet tregtia.

Të intervistuar në anketimin tonë janë 65 banorë ku në bazë të përgjigjeve të tyre dy problematikat kryesore janë:

- 1- Ndriçimi i lagjeve dhe rrugëve
- 2- Qendrat sociale dhe kulturore
- 3- Infrastruktura në shkolla dhe kopshte
- 4- Infrastruktura rrugore dhe sinjalistika rrugore
- 5- Largimi dhe trajtimi i mbetjeve

Cit nga banorët: “shume e rrugicave ne lagje jane te paaksesueshme per mungese te ndricimet, dhe behen gjithashtu objekt aksidentesh apo aktivitetesh ilegale...”


Cit nga banorët: “Qendrat sociale dhe kulturore, pasi rrethi i Kurbinut nuk ju ofron rinise shume mundesi per tu socializuar...”

Cit nga banorët: “te kete me shume investime ne laboratoret e shkolles...”

Cit nga banorët: “Shume probleme ka me ndricimin e rrugëve dhe me pastrimin e qytetit...”

Cit nga banorët: “Mbetjet Jane sketerre neper lagje shume problem...”



Për Qytetin  *Vendos ti*

QytetarIN RRETH NESH PETICIONI INICIATIVA QYTETARE KESHILLI BASHKIAK AKTIVITETE

MERR PJESË NË PETICION .

RRITJA E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE NË VENDIMMARRJE

PETICIONI/ INICIATIVA Elektronike

Demokracia digjitale në nivel vendor www.p...

Watch on YouTube

ANËTARËT KESHILLI BASHKIAK

KOMISIONET KESHILLI BASHKIAK

VENDIMET KESHILLI BASHKIAK

LIGJ NR. 139/2015 PËR VETEOVERISJEN VENDORE

LAJMI I FUNDIT .

Qëndresa Qytetare dhe Durrësi Aktiv nismë të përbashkët Për Qytetin

Peticione/ Iniciativa të realizuara

Peticion/ Initiative Aktive

Nis një Peticion ose Initiative

Shkarko Aplikacionin

Google Play

HARTA E PROBLEMATIKAVE DHË NEVOJAVE EMERGJENTE PËR NDËRHYRJE NË NIVEL VENDOR .

www.perqytetin.com



Nis një peticion ose Iniciativë

*Tu mungojnë shërbimet dhe infrastruktura në lagjen tuaj?
Doni të propozoni një akt që sjell ndryshim në bashkinë tuaj?
Besoni se keni mbështetjen e komuniteti që ju rrethon?
Qëndresa Qytetare ju inkurajon t'i drejtoheni Këshillit Bashkiak me Peticione dhe Iniciativa Qytetare për çështje që ju shqetësojnë dhe që lidhen me qytetin ku banoni*

Për Qytetin  *Vendos ti*



**Qëndresa
Qytetare**



Financuar nga LevizAlbania



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

